




REPUBLIKA E KOSOVËS

REPUBLIC OF KOSOVA - REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E DEÇANIT

MUNICIPALITY OF DEÇANI - OPSTINA DEÇANI

Drejtoria për Arsim në Deçan

Nr.07-Zyrtarisht

Datë:26.02.2019

Deçan

Në bazë të Vendimit nr.139/2019 të dt.13.02.2019 të Inspektoratit të Punës në Gjakovë, konform dispozitave të nenit 8 pika 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr.03/L-212, si dhe nenit 5 pika (c) të Ligjit nr.03/L-068 për Arsimin në komunat e Republikës së Kosovës, nenit 4 dhe 5 të Udhëzimit Administrativ nr.07/2017 për rregullimin e Procedurave të konkursit në sektorin publik, Drejtoria për Arsim në Deçan, rishpall:

KONKURS PUBLIK

Për plotësimin e vendit të lirë të punës në këtë Institucion edukativo Arsimor aftësuese në komunën e Deçanit.

I. SH.F.M.U. " Faik Konica " në Ratish.

1. Një mësimdhënës të lëndës së matematikës për 15 orë mësimi në javë me kohë të caktuar.

Dokumentacioni i kërkuar për konkurrim :

- Formulari i aplikimit merret në DKA –Deçan,
- Rezumeja personale (CV),
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë) kopje,
- Diplomat e kualifikimit (ose certifikatat) të noterizuara të noteri, certifikata në vend të diplomës mos të jenë më të vjetra se gjashtë muaj nga data e diplomimit,
- Çertifikata që nuk jeni nën hetime
- Dëshmi të përvojës në arsim (nëse ka), dhe
- Trajnimet të akredituara nga MASHT (nëse ka).

KUSHTET

Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara me akte juridike që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar (Ligji nr.02/L-52, Ligji nr.03/L-068 dhe Ligji nr.04/L138) dhe në përputhje me Udhëzimin Administrativ përkatës të MASHT-it UA nr.17/2009 si dhe UA nr.10/2018 dhe procedurave të përcaktuara me kornizën ligjore për rregullimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik..

Kriteret e Kualifikimit për lëndën e matematikës.

- Niveli Master arsimor-Fakulteti i Edukimit (300 ECTS).
- Sistemi katërvjeçar.
- Baçelor katërvjeçar -240 ECTS.

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Pas plotësimit të dispozitave ligjore dhe kriterëve të konkursit publik, kandidatët do ti nënshtrohen testit me shkrim .Testi me shkrim në maksimum tërheqë 100 pikë apo deri në 50% të vlerësimit përfundimtar.

Pikët nga testi me shkrim dhe intervista me gojë, mbledhen në shumën e përgjithshme dhe kandidatët me më shumë pikë do të përzgjidhen në pozitat e lartcekura.

Për intervistë do të ftohen ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për test ,intervistë si dhe orari i intervistave publikohet në ueb faqen e komunës së Deçanit <https://kk.rks-gov.net/deçan/>.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit.27.02.2019 e deri më datën dt.13..03.2019.

		DOKUMENTI I IDENTIFIKIMIT REPUBLIKA E KOSOVES - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇANE - DEÇAN MUNICIPALITY	
Nr. i dokumentit	DRJ. ARSIM	Nr. i identifikimit	5903
Nr. i referencës	07	Nr. i referencës	26.02.19
DEÇAN DEÇANE			



Drejtori,
[Signature]
Mr.sc. Bekim Vishaj